



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

**PROGRAMI KOMBËTAR I BURSAVE TË REPUBLIKËS SLOVAKE  
VITI AKADEMIK 2024-2025**

Agjencia Sllovaqe Akadematike dhe Informative (SAIA), njofton mbi hapjen e aplikimeve të Programit Kombëtar të Bursave të Republikës Sllovaqe për studime, kërkime, mësimdhënie dhe art për vitin akademik 2024-2025.

Programi Kombëtar i Bursave të Republikës Sllovaqe, i cili financohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Hulumtimit dhe Sportit mbështet lëvizshmërinë e studentëve ndërkombëtarë, të doktoraturës, mësuesve të universiteteve, studiuesve dhe artistëve për të qëndruar në universitetet dhe organizatat kërkimore sllovaqe në Sllovaki.

Me rastin e hapjes së thirrjeve për aplikim, SAIA organizon një webinar informues mbi mënyrën e përgatitjes së një aplikimi për bursë në këtë program. Webinari i dedikuar për aplikantët e huaj do të mbahet të premtën, në datën 22 Mars 2024, në orën 13:00.

Afati përfundimtar i aplikimit është **më 30 Prill 2024**. Aplikimi duhet të dorëzohet **online** (aplikanti duhet të plotësojë aplikimin online, të bashkëlidhë të gjitha dokumentet e kërkuara në formularin e përcaktuar). Për më tepër informacion në lidhje me aplikantët e huaj mund të vizitoni linkun:

<https://www.scholarships.sk/en/main/programme-terms-and-conditions/foreign-applicants> ose  
<http://www.stipendia.sk>

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi mund të informohen më tepër dhe të aplikojnë në faqen web: [www.scholarships.sk](http://www.scholarships.sk) ose të kontaktojnë personat e kontaktit me adresat si më poshtë:

- Informacion për studentët dhe studentët e doktoraturës në adresën [nsp-foreign2@saisa.sk](mailto:nsp-foreign2@saisa.sk);
- Informacion për mësuesit e universitetit, punojësit kërkimorë dhe/ose artistikë në adresën [nsp-foreign@saia.sk](mailto:nsp-foreign@saia.sk).